



AGJENCIA E KOSOVËS PËR FORENZIKË



RAPORTI VIETOR
2023



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme

Ministarstvo Unutrašnjih Poslova/ Ministry of Internal Affairs



AGJENCIA E KOSOVËS PËR FORENZIKË

Kosovska Agencija za Forenziku | Kosovo Agency on Forensic

RAPORTI VJETOR

2023

Tabela e përmbajtjes

Hyrje.....	3
Fjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv	5
1. Përmbledhja Ekzekutive	7
2. Inspektori i Përgjithshëm.....	13
3. Divizioni për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme	14
4. Divizioni për Cilësi.....	16
5 Departamenti për Traseologji Forenzike.....	19
5.1. Divizioni për Administrimin e Provave	19
5.2. Divizioni për Dokumente dhe Dorëshkrime	21
5.3. Divizioni i Balistikës.....	23
5.4. Divizioni i Daktiloskopisë dhe Traseologjisë	26
6. Departamenti për Kimi dhe Biologji Forenzike.....	29
6.1. Divizioni i ADN-së dhe Serologjisë.....	29
6.2. Divizioni për Analiza Kimike të Narkotikëve.....	32
6.3. Divizionit për Analiza të Eksplozivëve dhe Zjarrvënjeve	35
7. Departamenti për Teknologji Informative Forenzike	37
7.1. Divizioni për Ekzaminim të Kompjuterëve	37
7.2. Divizioni për Ekzaminim të Imazheve Digjitale, Videos dhe Audio.....	40

Hyrje

Raporti Vjetor i vitit 2023, i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë i ofron publikut të gjerë, pa përjashtim informata, njohuri dhe të dhëna të rëndësishme për punët, detyra, përgjegjësit, zhvillimet dhe shërbimet që kryhen në këtë institucion shtetëror përgjegjës për ofrimin e shërbimeve forenzike (analiza-ekspertiza Balistike, Daktiloskopike, Traseologjike, Dokumente dhe dorëshkrimet, analiza të ADN-së, të Narkotikëve, Eksplozivëve, Zjarrevëniet, Grimcave të Barotit, analiza të kompjuterëve, telefonave, fotografive, zërit etj), për gjykata, prokurori, polici dhe institucione tjera të zbatimit të ligjit në Republikën e Kosovës.

Misioni i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë është që përmes ushtrimit të veprimtarisë së saj, të ofroj shërbime forenzike cilësore në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet vendore dhe ndërkombëtare. Si institucion shtetëror është themeluar me ligj si agjenci e pavarur ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe ka organizimin e saj të brendshëm në nivel të departamenteve dhe divizioneve (laboratorëve), ku secila njësi ka detyrat e veta të përcaktuara sipas llojit dhe fushës së ekspertizave forenzike që kryen.

Për shkak të veprimtarisë që ka, Agjencia përdorë disa sisteme elektronike-baza të të dhënave për tërë Kosovën, siç janë AFIS, IBIS, CODIS, EVOFINDER dhe LIMS etj, në këto baza ruhen të dhënat e nevojshme që përdorën për kërkime dhe krahasime të profileve dhe personave që potencialisht mund të jenë kryerës të veprave penale.

Si institucion shtetëror me përgjegjësi të madhe për sistemin e sigurisë dhe drejtësisë, në kryerjen e detyrave, përkatësisht shërbimeve forenzike bazohet vetëm në kritere shkencore për të arritur deri të rezultatet e caktuara në fushat përkatëse të shkencës forenzike. Andaj metodat dhe pajisjet që përdoren për ekspertizë janë të akredituara sipas standardeve ndërkombëtare. Ndërsa burimet njerëzore janë të afta dhe profesionale në përmbushjen e detyrave të tyre.

Me krenari mund të themi, bazuar në vlerësimet e të tjerëve që janë bërë për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, se AKF-ja është ndër institucionet me besueshmëri më të lartë në vend dhe më gjerë.

Në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë punojnë me përkushtim dhe profesionalizëm të lartë 50 punonjës, ku 30 prej tyre janë të gjinisë mashkullore ndërsa 20 janë të gjinisë femërore.

Niveli i arsimimit të punonjësve të AKF-së është i lartë duke filluar nga bachelor deri në Doktor shkence. Të gjithë ekspertet që kryen ekspertiza forenzike kanë specializime dhe certifikime ndërkombëtare në lëmi të ndryshme forenzike. Poashtu ata i nënshtrohen testet të aftësive profesionale në baza vjetore nga Kompani ndërkombëtar të certifikuara si CTS (Collaborative testing Service) me seli në SHBA apo UNDOC me seli në Vjenë, duke treguar gjithmonë rezultate kulminante.

Fjala hyrëse e Kryeshefit Ekzekutiv



Dr. sci. Blerim OLLURI

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

I nderuar lexues,

Ju drejtohem me kënaqësi të gjithë juve që po e lexoni Raportin Vjetor 2023, të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, ku përmes së cilit do të njoftoheni për punët, detyrave, sukseset dhe vështirësitë që na kanë përcjellë gjatë vitit 2023.

Më kënaqësi mund te konstatoj se shumica e objektivave, aktiviteteve te planifikuara dhe te realizuara janë fal punës dhe angazhimit të gjithë personelit, të cilët me përkushtim, profesionalizëm të lartë dhe mbi të gjitha me nderë dhe besnikëri i kanë shërbyer detyrave që ju kanë përcaktuar.

Gjithashtu menaxhmenti dhe i tërë personeli i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë është angazhuar për përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë se shërbimeve, ngritjen e besimit tek palët, ngritjen e kapaciteteve forenzike dhe rritjen e profesionalizmit.

Duke u bazuar në detaje të hollësishme dhe në të dhënat konkrete nga të gjitha departamentet të AKF-së, në mënyrë përmbledhëse do të mundohem të paraqes punën e palodhur te punonjësve te AKF-së për vitin 2023.

Rritja e konsiderueshme e provave ku rezulton se në vitin 2023 janë proceduar katër herë me shume prova krahasuar më vitin paraprak na jep shpresë dhe na motivon në ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve forenzike dhe ngritjen e besimit tek palët. Agjencisë së Kosovës për Forenzikë gjatë vitit 2023 ka pasur bashkëpunim me institucionet vendore dhe ato ndërkombëtarë te cilat kanë ndikuar pozitivisht në avancimin e kapaciteteve teknologjike në fushën e forenzikes.

Vlen te theksohet se me sukses dhe profesionalizëm te larte Agjencia e Kosovës për Forenzikë ka menaxhuar te gjitha dëshmitë e sjella për ekspertim te rastit terrorist “ Banjska”, ku me një plan operativ i tërë personeli i AKF-së ka dhënë kontributin maksimal që në afat rekord të behet edhe ekspertimi i të gjitha provave të sjella në AKF.

Duket e lehtë që në këtë raport të përshkruhen të gjitha të ndodhurat e vitit të kaluar, mirëpo në realitet punët, detyrat dhe sukseset e arritura të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë janë fal punës dhe angazhimit të të gjithë personelit, të cilët me përkushtim, profesionalizëm të lartë dhe mbi të gjitha me nderë dhe besnikëri i kanë shërbyer detyrave që ju kanë përcaktuar nga shteti, vetëm e vetëm për të mundësuar që vërteta të dal në shesh në gjykatë, e kjo është mundësuar nga ekspertizat forenzike dhe dëshmitë e dhëna nga zyrtaret-ekspertet forenzike të AKF-së.

Me krenari mund të themi se edhe viti 2023, për AKF-në, ka qenë një vit i suksesit dhe arritjeve, për të cilat ju ftoj ti kuptoni në këtë raport.


1. Përmbledhja Ekzekutive

Përmes këtij raporti vjetor 2023, janë përmbledhur punët dhe detyra e kryera nga divizionet-laboratorët dhe aktivitetet e përgjithshme që kanë ndodhur në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë gjatë vitit 2022, duke e nisur me atë se gjatë këtij viti janë kryer me sukses 4547 ekspertiza forenzike me rreth 149,378 dëshmi përcjellëse nga fusha e ADN-së, ekzaminim në IT-forenzike (krime kibernetike), balistikës, dokumenteve, nënshkrimeve dhe dorëshkrimeve, narkotikëve, daktiloskopisë dhe traseologjisë, eksplozivëve dhe zjarrvënjeve.

Gjithashtu kemi pasur kërkime dhe identifikime të kryesve të veprave penale në data baza nacionale forenzike si: AFIS (Automated Fingerprint Identification System), CODIS (Combine DNA Index System) dhe IBIS (Integrated Ballistic Identification System) sipas kërkesave të Prokurorive, Gjykatave, organeve tjera të zbatimit të ligjit dhe Interpolit.

<i>Divizionet</i>	<i>Raste</i>	<i>Dëshmi</i>
<i>Divizioni i Dokumenteve dhe dorëshkrimeve</i>	964	50,106
<i>Divizioni i Balistikës</i>	1,284	47,750
<i>Divizioni i Daktiloskopisë dhe Traseologjisë</i>	638	22,201
<i>Divizioni i Serologjisë dhe ADN-së</i>	250	21,650
<i>Divizioni për Analiza Kimike të Narkotikëve</i>	857	4,888
<i>Divizioni për Analizë Kimike të Eksploziveve</i>	64	260
<i>Divizioni për Ekzaminim të Kompjuterëve</i>	401	1,829
<i>Divizioni për Ekzaminim të Imazhit, Videos dhe Zërit</i>	89	694
<i>Rastet e përfunduara</i>	4547	149,378

Tabela 1. Statistikat e rasteve të përfunduara - (ekspertizave forenzike) gjatë vitit 2023.



Grafiku 1. Statistikat e përgjithshme të rasteve (ekspertizave forenzike) gjatë vitit 2023.

Agjencia e Kosovës për Forenzikë gjatë vitit 2023 ka pasur numër të madh të kërkesave/urdhëresave nga Prokurorit, Gjykatat dhe institucionet e sigurisë për kryerjen e rasteve urgjente, sidomos për ekspertime të ADN-së, IT Forenzike (krime kibernetike) dhe grimca të barotit pas qitjes me armë.

Në kuadër të këtyre detyrave janë realizuar edhe shumë pjesëmarrje në seanca gjyqësore në cilësi të ekspertit dëshmitar nga zyrtarët e AKF të cilët kanë dhënë mendime e këshilla profesionale. Po ashtu ekspertet kanë marrë pjesë në shumë raste për ofrimin e ndihmës speciale për marrje të gjurmëve, marrje të mostrave të nënshkrimeve dhe dorëshkrimeve si dhe pjesëmarrje në rikonstruim të vendit të ngjarjes, etj.

Nga EMCDDA (European Monitoring Center for Drugs and Drug Addictions) – Qendra Evropiane për monitorimin e Drogave dhe të varurve nga Drogat, ndër to edhe për substanca të reja psiko-aktive, gjatë këtij viti janë pranuar dhe janë përcjellë informatat për 36 substanca të reja psiko-aktive të shpallura si të ndaluara dhe të rrezikshme në nivel të BE-së.

Gjatë vitit 2023 delegacioni i Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, udhëhequr nga Kryeshefi Ekzekutiv Dr. Blerim Olluri, me ftesë dhe në përkrahje të autoriteteve amerikane kanë marrë pjesë në “American Academy of Forensic Sciences, 75st Annual Scientific 2023” në Orlando-Florida USA .



Foto 1. Pjesmarrja në në “American Academy of Forensic Sciences, 75st Annual Scientific 2023” në Orlando-Florida USA.

Gjithashtu në kuadër të Programit të Shkëmbimit të CEPOL (CEPOL Exchange Programme) për vitin 2022, në fushën e Forenzikës, një ekspertë nga fusha e dokumenteve dhe Dorshkrimeve ka qëndruar në Laboratorin e Policisë në Stamboll për një javë duke shkëmbyer te gjitha përvojat forenzike te kësaj fushe. Po ashtu një jave ka qëndruar në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë Kosovë një ekspert nga Turqia i te njëjtës fushë në kudër të këtij programi të shkëmbimit.

Ekspertët e AKF-së i janë nënshtruar 4 testeve të aftësive profesionale nga CTS dhe nga UNODC dhe pas analizimit, vlerësimit dhe krahasimit të rezultateve ekspertët pjesëmarrës i kanë kaluar me sukses testet sipas konfirmimit të rezultateve.

Nga zyrtarët-ekspertët e Divizionit të Serologjisë dhe ADN-së është zhvilluar procedura e re dhe është kryer validimi i kitit për kuantifikim të ADN-së - Quantifiler Trio (ABI) ne Instrumentin QuantStudio 5. Gjatë vitit 2023 është punuar në revizionimin vjetor të procedurave teknike të punës bazuar në kriteret e standardit ISO 17025:2017.

Në muajin dhjetor kemi bërë vlerësimin ndërkombëtar nga vlerësuesit e certifikuar nga Turqia për procesin e riakreditimit dhe akreditimit të Laboratorëve të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë



Foto 2. Pritja e Delegacionit të eksperteve nga Turqia gjatë procesit të ri-akreditimit

Agjencia e Kosovës për Forenzikë gjatë vitit 2023 ka pranuar dy donacione në vlerë mbi 100,000 euro. Donacioni i parë është pranuar nga UNDP ku janë pranuar pajisje forenzike Stereoskop dhe Boroskop për Divizionin e Balistikes, pajisje këto për ekzaminimin e armëve të zjarrit.



Foto 3. Foto nga Nënshkrimit i Pranim dorëzimit të Donacionit nga UNDP.

Në ambientet e Agjencisë së Kosovës për Forezikë në mikpritje të Kryeshefit ekzekutiv të Agjencisë së Kosovës për Forezikë Dr. Blerim Olluri u mbajt ceremonia e pranim-dorëzimit të pajisjeve forenzike për Divizionin e AND-së dhe Serologjisë.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin Ambasadori i Suedisë z. Jonas Westerlund, Zëvendësues i Misionit të Italisë në Kosovë z. Ugo Ferrero.



Foto 4. Foto nga Nënshkrimi i Pranim dorëzimit të Donacionit nga ICMP.



Foto 5. Pranim dorëzimit të Donacionit nga UNDP.

Agjencia e Kosovës për Forenzikë ka buxhet të pamjaftueshëm në kategoritë ekonomike “mallra dhe shërbime” si dhe pamundësi për të rekrutuar staf të nevojshëm profesional (ekspert) sipas buxhetit të aprovuar për shkak të ndryshimeve dhe paqartësive ligjore.

2. Inspektori i Përgjithshëm

Bazuar në mandatin, detyrat dhe përgjithësitë të cilat dalin nga legjislacioni në fuqi i AKF-së, Inspektori i përgjithshëm është përgjegjës për Inspektimin e punës dhe veprimtarisë së brendshme në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë përfshirë këtu zbatimin e legjislacionit, sugjerimet për përmirësimin e performancës së personelit të AKF-së, apo eliminimin e dukurive të mundshme negative. Inspektori i përgjithshëm gjatë vitit 2023 ka kryer të gjitha inspektimet të cilat janë autorizuar nga Kryeshefi ekzekutiv.

Me autorizimin e Kryeshefit ekzekutiv Inspektori i përgjithshëm ka ndihmuar edhe Zyrën e Kryeshefit ekzekutiv në mënyrë të vazhdueshme në hartimin e raporteve të ndryshme që janë kërkuar nga palët e jashtme. Inspektori i përgjithshëm është kujdesur për të gjitha takimet dhe Agjendën e Kryeshefit ekzekutiv. Po ashtu i ka ofruar informacione të duhura Kryeshefit ekzekutiv sa herë që janë kërkuar nga ai.

Inspektori i përgjithshëm me autorizimin e Kryeshefit ekzekutiv është kujdesur për përditësimin e lajmeve dhe mirëmbajtjen Ueb-faqes zyrtare të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë, po ashtu ka ndihmuar në procesin e rishikimit vjetor të strategjisë Zhvillimore të AKF-së 2022-2026.



Foto 6. Foto e realizuar me rastin e procesit të vlerësimit të riakreditimit në AKF.

3. Divizioni për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

Divizioni për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme (DFSHP) edhe gjatë vitit 2023, si njësi e veçantë në kuadër të organizimit të brendshëm të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë edhe përkundër sfidave që ka pasur në mungesës të personelit të mjaftueshëm, ka realizuar të gjitha detyrat, përgjegjësit dhe punët që janë përcaktuar nga legjislacioni dhe drejtuesit e AKF-së.

Realizimi i detyrave dhe përgjegjësve që ka ky Divizion janë shumë më të rëndësishme për të mos thënë se punët që i kryen ky Divizion nga zyrtarët e saj mundësojnë funksionimin e rregullt të veprimtarisë dhe aktiviteteve të përditshme të AKF-së.

Në mënyrë të përmbledhur këto punë kanë të bëjnë me menaxhimin dhe mirëmbajtjen e informatave për burimet njerëzore (çështjet e personelit, pagave, mëditjet, pushimet, etj.) këshillimin dhe mbikëqyrjen e realizimit të legjislacionit për burime njerëzore, hartimin e shkresave dhe akteve tjera administrative,

Pastaj hartimin, menaxhimin koordinimin, përgatitjen, zbatimin, raportimin dhe vlerësimin e buxhetit të agjencisë (vlerësimin e kërkesave financiare, pagesat ndaj operatorëve, inicimin e procedurave për prokurim etj.).

DFSHP me sukses ka kryer procesin e rekrutimit të tre punonjësve të ri për Divizionin e ADN-së dhe të IT-së Forenzike.

Angazhimin dhe kujdesin për furnizimin e rregullt të AKF-së me mallra dhe shërbime sipas kërkesave dhe nevojave të njësive, menaxhimi dhe mbikëqyrja e shërbimeve të mirëmbajtjes teknike dhe higjienike të objektit,

Kontrollim ditor i sistemeve të klimatizimit qendror, sigurisë, gazrave, ventilimit, ujit dejonizues, elektrikes, menaxhimi i kontratave për shërbime të mirëmbajtjes teknike të sistemeve, automjeteve, furnizimeve me material shpenzues etj.

Organizmin dhe ofrimin e shërbimeve të transportit, logjistikës, pjesëmarrjen në komisione të ndryshme siç ishin ato për legjislacion, inventarizim, pranim, hapje dhe vlerësim të tenderëve, komisione për çështje të brendshme, etj.

Gjithashtu janë realizuar 132 kërkesa për pagesë, është hartuar Korniza Afatmesme e Shpenzimeve (KASH) 2024-2026, të gjitha kërkesat e inicimit të prokurimit janë ngritur sipas planit prokurimit MPB 2023, është përgatitur Buxheti i planifikuar për vitin fiskal 2024, janë përgatitur raporte në periudhat tre mujore, për shpenzimet e vijës buxhetore të AKF, është bërë dhe ekzekutuar Plani i Rrjedhës së Parasë për vitin fiskal 2023.

Janë mbajtur korrespondenca të vazhdueshme me Departamentin e Buxhetit dhe Financave dhe Divizionin e Prokurimit në MPB, për të qenë sa më efikas në realizimin e kërkesave që kanë dal nga AKF.

4. Divizioni për Cilësi

Sigurimi i cilësisë dhe kompetencës janë ndër temat më të rëndësishme gjatë kryerjes së ekspertimeve forenzike. Divizioni i cilësisë mbështet laboratorët e AKF-së në përputhje me standardet dhe praktikatat më të mira ndërkombëtare duke përfshirë arritjen dhe ruajtjen e akreditimit. Ndjekja e versioneve të reja të Standardit Ndërkombëtar ISO/IEEC:17025:2017, përmirëson vazhdueshëm cilësinë në fushat e ndryshme forenzike.

Divizioni i Cilësisë në kuadër të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë gjatë vitit 2023 ka zhvilluar dhe zbatuar legjislacionin i cili është në funksion të ruajtjes së integritetit të ekspertizave forenzike. Divizioni i cilësisë ka arritur progres të dokumentuar në sigurimin e cilësisë me një plan të qartë për vazhdimin dhe ruajtjen e akreditimit që nga viti 2015.

Divizioni i Cilësisë bazuar në legjislacionin në fuqi të AKF-së është përgjegjës për verifikimin dhe sigurimin e cilësisë së ekspertizave, planifikimin dhe menaxhimin e testeve të zotësisë/ushtrimeve grupore për punonjësit shkencor. Gjithashtu, ka procedurë dhe mekanizëm për kontrollin e cilësisë, sigurimin, funksionimin dhe kalibrimin e aparaturës dhe pajisjeve forenzike, zhvillimin dhe rekomandimin e metodave shkencore të punës, koordinimin, përgatitjen dhe vazhdimin e procesit të akreditimit për Divizionet/Laboratorët e AKF-së.

Divizioni i Cilësisë duke u bazuar në procedurat mbështetëse të AKF-së dhe normave ndërkombëtare ISO/IEC 17025 ka bërë analizën e përgjigjeve dhe opinioneve të palëve të institucioneve për zbatimin e ligjit të Kosovës qofshin ato pozitive apo negative lidhur me shërbimet forenzike që ofron. Opinionet analizohen për të përmirësuar: sistemin menaxhues, veprimet analitike dhe shërbimet forenzike për palët.

Pyetësorët janë plotësuar në mënyrë manuale dhe elektronike. Në gjashtë mujorin e dytë të vitit 2023 është mbajtur procesi vlerësues i mbikëqyrjes nga ekspertet ndërkombëtar për akreditimin, ri akreditimin dhe zgjerimin e metodave shkencore forenzike për laboratorët e Agjencisë së Kosovës për Forenzikë.

Divizioni i cilësisë gjatë vitit 2023 ka punuar në rritjen e efikasitetit dhe sigurinë e cilësisë për ekspertizë forenzike, ka siguruar që të gjitha raportet e ekspertizave forenzike të kenë kriteret e kërkuara sipas standardeve dhe metodologjive bashkëkohore.

Gjithashtu Divizioni i Cilësisë gjatë vitit 2023 ka pasur një rol mbikëqyrës në krijimin dhe aranzhimin e testeve të aftësive profesionale nga kompania International Collaborative Exercises, (ICE) UNODC, testeve të brendshme dhe ka analizuar rezultatet e testeve të aftësive profesionale duke ngritur komisione për vlerësimin e rezultateve.

Divizioni për Cilësi në kuadër të AKF-së ka ndikuar drejtpërdrejt në ngritjen dhe kontrollin e cilësisë duke zhvilluar dhe zbatuar procedurat e këtij divizioni të cilat janë në funksion të ruajtjes së integritetit të ekspertizave forenzike, duke motivuar personelin shkencor në kërkimin dhe vlefshmërinë e teknikave të reja, procedurave, metodave dhe pajisjeve të përdorura në divizione.

Në divizionin e cilësisë gjatë këtij viti janë realizuar disa aktivitete në raport me divizionet e AKF-së, si dhe në raport të realizimit të kërkesave të përgjithshme të Standardit Ndërkombëtar ISO/IEC 17025:2017, ku të gjitha aktivitetet janë të paraqitura si më poshtë:

- Monitorimi, sigurimi dhe planifikimi i testeve të aftësive profesionale nga kompania International Collaborative Exercises (ICE) dhe United Nations Office on Drugs and Crime (UNODC - Zyra e Kombeve të bashkuara për Droga dhe Krime) për Divizionin për Analiza kimike të narkotikeve si dhe planifikim-monitorimi i testeve të brendshme për stafin e AKF-së, të cilave teste iu ka nënshtruar personeli.
- Rishikimi administrativ i raporteve të ekspertizave forenzike, për personelin shkencor të AKF-së.
- Rishikimi dhe aprovimi i procedurave teknike të gjitha divizioneve/laboratorëve të revizionuara gjatë vitit 2023.
- Divizioni i Cilësisë ka pasur bashkëpunim dhe koordinim me Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP), duke mbajtur trajnimin **“Për ndihmë të parë dhe frymëmarrje artificiale”** nga instruktorët e certifikuar të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike për gjithë punonjësit e AKF-së.
- Divizioni i Cilësisë ka qenë pikë kontakti për bashkëpunim dhe bashkë koordinim me Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) në kuadër të Programit të Shkëmbimit /CEPOL/, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve në fushën e trajnimeve dhe aftësive profesionale nga të gjitha aktivitetet që ofron CEPOL.
- Është përfunduar **Hartimi i Planit të Integritetit** sipas vendimit të Kryeshefit me numër protokolli: AKF/2023-153.

- Divizioni i cilësisë ka bere inspektimin e hapësirës së punonjësve rreth aplikimit te masave mbrojtëse për shëndet dhe siguri në të gjitha Divizionet.
- Është mbajtur trajnimi më datë 27.02.2023 deri 03.03.2023 **“Trajnimin për zhvillimin e gjurmëve të vijave papilare me metoda të ndryshme fiziko-kimike”**.
- Udhëheqje dhe pjesëmarrje në Komisione të niveleve të ndryshme institucionale brenda dhe jashtë Agjencisë së Kosovës për Forenzikë/AKF/.
- Koordinimi i zhvillimit-validimit të metodave ekzistuese si dhe metodave të reja shkencore për akreditim.
-



***Foto 7.** Ekspertet nga Divizioni i Balistikës gjatë trajnimit për përcaktimin e distancës së qitjes me metoda kimike .*

5. Departamenti për Traseologji Forenzike.

Departamenti për Traseologji Forenzike, si njësi përbërëse e AKF-se, ka numrin me të madhë të zyrtarëve të dhe kryen numrin më të madhë të ekspertizave forenzike. Në kuadër të këtij departamenti bëjnë pjesë:

- Divizioni për Administrimin e provave,
- Divizioni i Dokumenteve dhe dorëshkrimeve,
- Divizioni i Balistikës,
- Divizioni i Daktiloskopisë dhe Traseologjisë.

5.1. Divizioni për Administrimin e Provave

Divizioni për Administrimin e Provave është përgjegjës për pranimin, dorëzimin dhe ruajtjen e provave, sistemimin, organizimin dhe mirëmbajtjen e arkivës, së AKF-së si dhe njoftimin e palëve për çështjet që kanë të bëjnë me ekspertizën, etj.

Nga ky divizion gjatë vitit 2023 janë administruar katërmijë e shtatëqindnjëzetepesë (4725) raste me gjithsej dyqindeshtatë mijë e pesëqindnëntëdhjeteshtatë (207597) dëshmi për ekspertime forenzike dhe kërkesave për kërkime në databaza nacionale forenzike si: IBIS, CAFIS dhe CODIS sipas kërkesave të Prokurorive, Gjykatave, Organeve tjera të zbatimit të ligjit dhe Interpolit.

Me sistemin LIMS-ë janë pranuar katërmijënjëqindeshtatëdhjetenjë (4171) raste me gjithsej dyqindegjashtë mijë e njëqindeshtatë (206107) prova për ekspertim dhe jashtë sistemit LIMS janë pranuar pesëqindepesëdhjetekatër (554) raste, me gjithsej njëmijekatërqindnëntëdhjetë (1490) prova për ekspertim.

	Raste të pranuara përmes LIMS-it	Prova të pranuara përmes LIMS-it	Raste të Pranuara jashtë LIMS-it	Prova të Pranuara jashtë LIMS-it	Gjithsej Raste të Pranuara	Gjithsej Prova të Pranuara
Divizioni për Administrimin e Provave	4171	206107	554	1490	4725	207597

Tabela 2. Në krahasim me vitin e kaluar kemi pranuar 292 raste me pakë, por 155138 prova më shumë.

	Kërkesa të Pranuara	Jashtë LIMS-it	Regjistruar në LIMS-ë	Raste të Dorëzuara	Provat për ekspertim
Divizioni për Administrimin e Provave	5000	608	4392	12038	207597

Tabela 3. Në krahasim me vitin e kaluar kemi pranuar 275 kërkesa me pakë, por 154594 prova më shumë.

Zyrtarët e këtij divizioni gjatë vitit 2023 kanë arkivuar 9352 lëndët dhe tri libra protokolli të vitit 2021 dhe 2022 në 198 folldera.

Gjithashtu, janë dorëzuar dhe pranuar 65 lëndë te ekspertët/inspektori për prezantim në gjykatë apo për nevoja tjera, si dhe është bërë inventarizimi i dhomës së provave. Po ashtu zyrtarët e Divizionit për Administrimin e Provave kanë përfunduar trajnimin për ndihmën e parë.



Foto 8. Zyrtarët e pranimit/dorëzimit gjatë regjistrimit të rasteve

5.2. Divizioni për Dokumente dhe Dorëshkrime

Divizioni i Dokumenteve dhe Dorëshkrimeve është përgjegjës për ekspertimin e dokumenteve, dorëshkrimeve/nënshkrimeve, kartëmonedhave, monedhave metalike, makinave të shkrimit, letrave me vlerë, etj.



Foto 9. Ekspertet e dokumenteve dhe dorëshkrimeve gjatë procesit të punës.

Gjatë vitit 2023 në Divizionin e Dokumenteve dhe Dorëshkrimeve janë kryer 964 ekspertiza forenzike me mbi 50.106 dëshmi në fushën e dokumenteve, dorëshkrimeve, nënshkrimeve dhe në veqani edhe gjatë këtij viti janë kryer me qindra ekzaminime të monedhave metalike, një dukuri negative mjaft e theksuar sikurse edhe vitin e kaluar.

Në këtë divizion ka rritje të numrit të ekspertizave forenzike të nënshkrimeve & dorëshkrimeve, të monedhave metalike si dhe të rasteve të natyrës urgjente të cilat kryhen sipas kërkesës së prokurorisë gjatë ditëve të pushimit javor dhe gjatë festave, po ashtu kemi kryer ekspertiza të certifikatave, targave të automjeteve të sjellura nga ARC (Agjencioni i Regjistrimit Civil) si dhe ekspertim të banderollave të sjellura nga AKPPM (Agjencia e Kosovës për produkte dhe pajisje medicinale).

Gjatë vitit 2023 Divizioni i Dokumenteve & Dorëshkrimeve ka pasur takim me zyrtarë nga Bashkimin Evropian, janë nxjerr statistikat (me të dhëna të detajuara) tre mujore për monedhat metalike të ekzaminuara (gjithsej 4.528). Këto statistika, Agjencia e Kosovës për Forenzikë ia dërgon ETSC (European Technical and Scientific Centre) në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit.

Gjithashtu personeli me ftesë të Gjykatës/Prokurorisë kanë marr pjesë në seanca gjyqësore në cilësinë e ekspertit për ekspertizat e kryera, po ashtu kemi pasur bashkëpunim të ngushtë me prokuror dhe gjyqtarë në fazën e hetimit të rasteve penale, si dhe shqyrtimit gjyqësor të rasteve civile dhe po ashtu në cilësinë e ekspertit kemi marrë pjesë në seancë të “ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT”.

Gjatë vitit 2023 ekspertët nga Divizioni i Dokumenteve dhe Dorëshkrimeve me datë 20-21.09.2023 kanë marrë pjesë në trajnimin e organizuar nga EULEX-i "Workshop and ad hoc trainings for Kosovo institutions dealing with counterfeit euro banknotes and coins" në të cilin kanë marrë pjesë: Banka Qendrore Evropiane, Komisioni Evropian dhe Europol.

Një ekspert nga divizioni i Dokumenteve & Dorëshkrimeve ka marr pjesë në Programi i Shkëmbimit në kuadër të (CEPOL Exchange Programme) nga data 1 deri me 6 tetor 2023 në Stamboll.



Foto 10. Ekspertet e dokumenteve dhe dorëshkrimeve gjatë qëndrimit në Stamboll- Programi i Shkëmbimit në kuadër të (CEPOL Exchange Programme).

Divizion i Dokumenteve dhe Dorëshkrimeve ka kontribuar duke dhënë intervista nëpër televizione të ndryshme lokale lidhur me identifikimin e kartëmonedhave dhe monedhave metalike ku qytetarët kanë pasur mundësi të marrin informata se si mund ti identifikojnë disa nga tiparet e sigurisë të cilat janë të dukshme me syrin e lirë dhe gjithashtu kemi marr pjesë në debate televizive mbi fenomenin e falsifikimit të monedhave metalike.



Foto 11. Ekspertet e dokumenteve dhe dorëshkrimeve gjatë procesit të punës -identifikimit të monedhave.

Me date 12, 13, 14 dhjetor 2023 është mbajtur procesi i akreditimit në Divizionin e Dokumenteve dhe Dorëshkrimeve nga eksperti Hakan Beyaz.

5.3. Divizioni i Balistikës

Divizioni i Balistikës është përgjegjës për ekspertimin e armëve të zjarrit, municionit, gëzhojave, plumbave, shurdhuesve të armëve, mekanizimit për tërheqje të këmbëzës, ekspertimin e numrave të karrocërës së automjeteve, restaurimin e numrave serik, përcaktimi i trajektoreve të të shtënave, krahasimet mikroskopike, etj.

Ky divizion gjatë vitit 2023 ka kryer gjithsej 1.284 ekspertiza forenzike nga fusha e balistikës dhe ekspertimit të numrave identifikues së automjeteve ku janë ekzaminuar rreth 47.750 prova materiale armë zjarri, fishekë, gëzhoja, plumba, rroba, vetura, incizime të ngjarjeve kriminale ku janë përdorur armët e zjarrit, etj).

Në sistem IBIS janë futur mostrat e rreth 300 armëve të regjistruara dhe të legalizuara me kërkesë të Departamentit për Siguri Publike të MPB-së, janë bërë rreth 425 identifikime në mes të armëve të sjella për ekspertim me gëzhoja dhe plumba po ashtu të sjell për ekspertim nga rastet kriminale, janë identifikuar 21 goditje (HITS) në Sistemin IBIS, ku janë identifikuar 17 armë të dyshuara, si dhe 4 të tjera ku janë identifikuar armë të dyshuara të njëjta të përdorura në dy raste të hapura.

Divizioni ka kryer një numër kërkesash të pranuar nga ILECU për verifikim në sistemin IBIS për armë të humbura apo vjedhura si dhe statistika të armëve të ekzaminuara për këtë drejtori të PK-së, janë hartuar dy raporte së bashku me statistika për raportimet e rregullta të MPB-së lidhur me zbatimin e objektivave të Udhërrëfyesit për Zvogëlimin Substancial të Armëve të Vogla dhe të Lehta në Evropën Juglindore 2020-2024. Po ashtu ekspertët e Divizionit të Balistikës kanë marrë pjesë në një numër të konsiderueshëm të seancave gjyqësore rreth njëzet (20) sosh ku kanë prezantuar si dëshmitarë ekspert si dhe pesë (5) rikonstruime të vendit të ngjarjes.

Vlen të përmendet se në Divizionin e Balistikës janë kryer edhe shtatë (7) ekzaminime me kërkesë të prokurorit të shtetit për identifikimin e armëve të zjarrit përmes fotografive apo videove të cilat personat e dyshuar i kanë publikuar në rrjetet sociale apo janë gjetur nëpër telefonat e tyre celular e ku në foto apo video shihen armë të zjarrit.




Foto 12. Eksperti nga Divizioni i Balistikës gjatë procesit të punës

Gjatë këtij viti janë pranuar në formë donacioni pajisjet si më poshtë:

- Tetë (8) stereoskopë (mikroskopë të thjeshtë) të teknologjisë së fundit të prodhuesit Leica Microsystems GmbH nga UNDP zyra në Kosovë,
- Pesë (5) boreskopë për ekzaminimin e tytave të armëve të zjarrit dhe veturave nga UNDP zyra në Kosovë,
- Dy (2) TriggerScan për ekzaminimin e mekanizimit tërheqës të shkrepjes së armëve të zjarrit nga UNDP zyra në Kosovë,
- Një (1) bazë e të dhënave për identifikimin e municionit CartWinPro me licencë të përdorimit dyvjeçare nga UNDP zyra në Kosovë, dhe
- Një (1) kontejner për testimin e armëve të zjarrit nga Ambasada e Francës në Kosovë.

Gjithashtu Divizioni i Balistikës gjatë vitit 2023 është furnizuar me inventar laboratorik si tavolina pune, ishuj laboratorik, sirtar metalik dhe digestor.

Personeli i Divizionit të Balistikës në vitin 2023 kanë marrë pjesë në trajnime dhe vizita studimore të ndryshme si më poshtë:

- Një në takimin e rregullit të grupit punues të ekspertëve të Armëve të Zjarrit të ENFSI të mbajtur në Bruksel, Belgjikë,
- Dy (2) në takimet e rregullta të Rrjetit të ekspertëve të Armëve të Zjarrit të Evropës Juglindore të organizuar dhe mbështetur nga SEESAC-u (njëri takim në Malin e Zi, kurse takimi tjetër në Bosnjë dhe Hercegovinë),
- Një (1) në takimin e rregullt vjetor të Pikave Qendrore të Armëve të Zjarrit të shteteve të Evropës Juglindore të organizuar dhe mbështetur nga SEESAC-u i mbajtur në Beograd, Serbi,
- Një (1) në vizitën studimore në Francë si anëtarë i Komisionit për Zbatimin e Planit të Udhërrëfyesit për zvogëlimin substancial të Armëve të Vogla dhe të Lehta në Ballkanin Perëndimor 2020-2024 i mbështetur nga Ambasada e Francës në Kosovë,
- I tërë personeli i Divizionit të Balistikës kanë ndjekur trajnimin për përcaktimin e distancës së qitjes me metoda kimike si dhe validimin e metodave për përcaktimin e distancës së qitjes me metoda kimike dhe restaurimin e numrave serik i mbështetur nga UNDP zyra në Kosovë.



Foto 13. Ekspertet nga Divizioni i Balistikës gjatë trajnimit për përcaktimin e distancës së qitjes me metoda kimike.

Gjithashtu personeli i Divizionit të Balistikës kanë marrë pjesë dhe në punëtori kryesisht të organizuara për njoftimin e Prokurorëve të Shtetit lidhur me llojllojshmërinë e ekspertimeve që mbulon Divizioni i Balistikës, pastaj ndihmën që ekspertët mund t’u ofrojnë prokurorëve të shtetit në lidhje me hetimin e veprave penale që kanë të bëjnë me armët e zjarrit, etj.

Në muajin Dhjetor të vitit 2023 është kryer vlerësimi teknik i jashtëm nga eksperti turk. Z. Mustafa MERCAN për vazhdimin e akreditimit të metodave sipas standardit ISO 17025:2017.

5.4. Divizioni i Daktiloskopisë dhe Traseologjisë

Divizioni i Daktiloskopisë dhe Traseologjisë është përgjegjës për ekspertimin: kryerja e ekspertimeve daktiloskopike dhe traseologjike, futja e të dhënave daktiloskopike në sistemin AFIS, dëshmimi për ekspertizën e kryer në cilësinë e ekspertit në Gjykata dhe Prokurori, etj.

Gjatë vitit 2023 ky divizion ka kryer 638 ekspertiza forenzikë, me rreth 22.201 dëshmi përcjellëse.

Ekspertët nga Divizioni i Daktiloskopisë & Traseologjisë kanë qenë të angazhuar për të ndihmuar Divizionin e ADN-së për shkak të numrit të madhe të rasteve në pritje.



Foto 14. Eksperti nga Divizioni i Daktiloskopisë gjatë procesit të punës.

Aktivitetet e realizuara:

Është bërë revizionimi i të gjitha dokumenteve si: procedurat teknike, metodat analitike, kalibrimin-servisim e pajisjeve, udhëzimet e punës, format standarde të punës etj.

Vizita e ekipit Teknik të sistemit automatik (Identifikimi i Shenjave të Gishtërinjve dhe Shuplakave të duarve si dhe Gjurmëve Latente) CABIS /Thales, ku me këtë rast është bërë kontrollimi i funksionimit të sistemit.

Pjesëmarrësit nga Thales, Alexandra Toader (Menaxhere e Mbështetjes dhe Mirëmbajtjes) dhe Aleksandar Petrov (Niveli-3 Mbështetje dhe Zhvillues Softuerësh)

Është bërë auditimi në Divizionin e Daktiloskopisë dhe Traseologjisë nga auditor të brendshëm.

Është bërë plotësimi i rekomandimeve lidhur me raportin e brendshëm të auditimit për vitin 2023, për Divizionin e Daktiloskopisë dhe Traseologjisë.

Procesi i vlerësimit nga ekspertët e jashtëm për ri-akreditimin e metodave të punës është bërë me datën 12 deri me 14.12.2023. Për realizimin e vlerësimit është angazhuar eksperti Nderkombetar Erdem Kara.

Është bërë vlerësimi vjetor për secilin Ekspert si dhe Teknik në baze të Rregullores, për vitin 2023.

Vlen të theksohet rasti terrorist Banjska, është bërë Ekspertimi i Rastit (nxitja /zhvillimi/ i gjurmëve latent të vijave papilare në Divizionin e Daktiloskopisë i cili ka pasur një numër voluminoz të dëshmive.

Personeli i Divizionit të Daktiloskopisë & Traseologjisë në vitin 2023 kanë marrë pjesë në trajnime, punëtori studimore të ndryshme si më poshtë:

- Trajnimi për zhvillimin /nxitjen/ e gjurmëve të vijave papilare me metoda të ndryshme fiziko-kimike, përkrahur nga OSBE (27 shkurt – 03 mars, 2023).
- Është mbajtur punëtorja „Workshop on the Outreach of the FFP and Ballistic Laboratory to the Prosecution office in support of firearms investigations” me Prokurorinë e Shtetit me datat 17 dhe 18.10.2023 në Swiss Diamond Hotel në Prishtinë, ku me këtë rast Eksperti i Daktiloskopisë ka sqaruar mundësin e nxitjes së gjurmëve të vijave papilare /probabilitetin/ të cilat mbesin në sipërfaqe të gëzhgojave pas shkrepjes nga armët e zjarrit.
- Punëtori e mbajtur me datën 29 Nëntor – 01 Dhjetor, për përkrahjen e komisionit (grupit punues për performancën të AKF-së, ku ka marr pjesë një Ekspert i Daktiloskopisë.
- Është mbajtur trajnimi “Për ndihmë të parë dhe frymëmarrje artificiale”, për gjithë punonjësit e AKF-së. Trajnimi është mbajtur nga instruktorët e certifikuar të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike.

6. Departamenti për Kimi dhe Biologji Forenzike

Departamenti për Kimi dhe Biologji Forenzike është njeri nga tri departamentet në nivel të AKF-së, dhe në kuadër të këtij departamenti funksionojnë tri Divizione:

- Divizioni i Serologjisë dhe ADN-së,
- Divizioni për Analiza Kimike të Narkotikëve dhe
- Divizioni për Analizë Kimike të Eksploziveve, Zjarrvënjeve dhe Grimcave të Barotit.

6.1. Divizioni i ADN-së dhe Serologjisë.

Divizioni i ADN-së dhe i Serologjisë është përgjegjës për kryerjen e analizave forenzike të ADN-së dhe analizave forenzike Serologjike (analizave të lëngjeve të ndryshme trupore, të cilat i paraprijnë analizave të ADN-së). Gjithashtu, Divizioni i ADN-së e mirëmban dhe menaxhon Bazën e të Dhënave të ADN-së – CODIS (futja, ruajtja dhe krahasimi i profileve të ADN-së për qëllime forenzike). Po ashtu, ka tri vite që Divizioni i ADN-së, i kryen edhe Testet e Atësisë të cilat bëjnë pjesë në kuadër të rasteve Civile.

Gjatë këtij viti Divizioni i ADN-së dhe i Serologjisë ka kryer me sukses mbi 250 ekspertiza të ADN-së me mbi 21650 dëshmi të ndryshme, poashtu janë realizuar një sërë aktivitete të rëndësishme.

Sa i përket dinamikës dhe numrit të rasteve në tabelën në vazhdim në formë tabelore janë paraqitur statistikat:

	Pranuara	Në Pritje	Në Proces	Ekzaminuara	Dëshmitë
Divizioni i Serologjisë dhe ADN-së	234	30	152	250	21 650

Tabela 4. Rastet e pranuar, përfunduar etj.

Gjithashtu gjatë vitit 2023 janë krijuar procedurat e reja për metodën e re - Kitin e ri të ADN-së GlobalFiler IQC PCR Amplification Kit, i cili ju ka nënshtruar procesit të validimit.

Validimi për kitin GlobalFiler IQC PCR Amplification Kit është kryer me sukses dhe ka filluar përdorimi i tij në raste forenzike, gjithashtu është planifikuar validimi për kitin tjetër Quantiplex Pro nga kompania e njohur QIAGEN, këto metoda të reja (kita të rinj) janë shumë më të avancuar dhe që kanë shumë rëndësi në zhvillimin e mëtejshëm të ekspertizave forenzike të ADN-së.

Gjithashtu ka vazhduar bashkëpunimi i laboratorit tonë, me laboratorët e ICMP-së, ku nga ky institucion ndërkombëtar gjatë këtij viti kemi përfituar edhe një donacion prej 4 instrumentesh të reja (një Inkubator të thate me lëkundje, një Centrifuge për Epruveta 50 dhe 15 ml dhe dy Pajisje Dremel për gërryerje të Eshtrave).



Foto 15. Eksperti i ADN-së, gjatë pipetimit.

Gjatë këtij viti në laboratorin e ADN-së janë zhvilluar këto aktivitete të rëndësishme:

Është bërë një punë e madhe sa i përket rastit të Banjskës, për çka i gjithë stafi i cili ka qenë i përfshirë në këtë rast kanë marrë Mirënjohje.



Foto 16. Ekspertët nga Divizioni i ADN-së gjatë procesit të punës në rastin Banjaska.

Divizionit të ADN-së në mostrimin e dëshmimeve të këtij rasti por edhe në shumë raste tjera (rreth 58 raste kriminale me mbi 1,000 dëshmi) ju ka ndihmuar stafi mbështetës prej 3 ekspertesh nga divizionet tjera, për çka ju jemi shumë mirënjohës.

Në laboratorin tonë është realizuar një Vizite pune, e një Eksperti nga kompania me renome QIAGEN me seli në Gjermani, me këtë rast është bërë Kalibrimi i ngjyrave për Kitin Quantiplex Pro për instrumentin e Kuantifikimit QuantStudio 5, në vijim pritet validimi i këtij Kiti.

Është kryer procesi i vlerësimit nga ekspert të huaj për procesin e Ri-Akreditimit dhe Akreditimit të metodave të reja.

Janë identifikuar 3 përputhje (persona të involvuar në raste penale), duke ju falënderuar Bazës së të Dhënave të ADN-së – CODIS.

Dy Ekspert të ADN-së me sukses e kanë kaluar Testin e Brendshëm të Aftësive Profesionale

Ekspertët e ADN-së, po ashtu kanë marrë pjesë aktive në punën e shumë komisioneve brenda dhe jashtë AKF-së, dhe janë treguar shumë të suksesshëm, duke dhënë kontributin e tyre në punën e këtyre komisioneve, për çështje të ndryshme të rëndësishme.

Sfidat

Divizioni i ADN-së dhe i Serologjisë është ballafaquar edhe me shumë sfida si mugesat e stafit, problemet teknike me sistemin LIMS dhe CODIS, dhe disa probleme tjera të cilat kanë ndikuar shumë në punën me raste.

Si pasojë e këtyre problemeve ka pasur vonesa të ekspertizave dhe grumbullim të rasteve në pritje.

Aktualisht janë në pritje/proces rreth 184 raste që presin përfundimin e ekspertizave të ADN-së.

Prandaj në të ardhmen nevojitet përkrahje më e madhe, përkrahje me staf të ri si dhe përkrahje më e madhe teknike dhe buxhetore.

Gjithashtu, jemi në proces të Renovimit dhe Ridizajnimit të hapësirave të punës në të gjithë Divizionin. Digjtorët e vjetër tashmë janë zëvendësuar me të rinjtë, proceset tjera janë në vazhdim e sipër.

6.2. Divizioni për Analizë Kimike të Narkotikëve.

Divizioni për Analizë Kimike të Narkotikëve është përgjegjës për analizën dhe identifikimin e narkotikeve, substancave psikotrope dhe prekursorëve duke përfshirë edhe substancat e reja psikoaktive.

Divizioni (Laboratori) për Analizë Kimike të Narkotikëve (DAKN) e ka realizuar me sukses planin dhe objektivat e parapara gjatë periudhës kohore 01.01.2023 deri më 31.12.2023.

Ky raport përfshinë të gjitha aktivitetet dhe veprimtaritë e zhvilluara, si dhe të arriturat të cilat janë realizuar me angazhimin maksimal të menaxhmentit dhe stafit të DAKN-së gjatë tërë vitit 2023, duke përfshirë numrin e rasteve të kryera, menaxhimin e kontratave, trajnime, mbështetjet dhe angazhimin në aktivitetet tjera të AKF-së.

Përmes këtij raporti do të përfshinë aktivitetet e zhvilluara dhe të arriturat kryesore të Divizionit për Analizë Kimike të Narkotikëve gjatë periudhës kohore: 01.01.2023 deri më 31.12.2023.




Foto 17. Ekspertet gjatë analizimit të mostrave në instrumente.

Duke u bazuar në statistikat vjetore të nxjerra nga sistemi LIM-s, Divizioni (Laboratori) për Analiza Kimike të Narkotikëve, gjatë vitit 2023 ka pranuar 980 raste të reja ndërsa janë kryer (analizuar) dhe rishikuar me sukses dhe profesionalizëm 857 raste, me gjithsej 4888 dëshmi.

Sa i përket dinamikës dhe numrit të rasteve në tabelën në vazhdim në formë tabelore janë paraqitur statistikat:

Rastet	Pranuara	Në Pritje	Në Proces	Ekzaminuara	Dëshmitë
Divizioni për Analiza Kimike të Narkotikëve	980	0	249	857	4888

Tabela 5. Rastet e pranuar, përfunduar etj.

Vlen të theksohet se raste urgjente dhe rastet me prioritet, janë trajtuar si urgjente dhe janë përfunduar me sukses në Divizionin për Analiza Kimike të Narkotikëve.

Pjesëmarrje e stafit në Gjykatë, gjatë këtij viti janë realizuar dy prezantime në cilësinë e ekspertit në Gjykatë, një në Mitrovicë dhe një në Prishtinë.

Ekspertët e Divizionit për Analiza Kimike të Narkotikëve kanë marr pjesë në webinarin (online) e organizuar dhe koordinuar nga EMCDDA me temën: “Methamphetamine in Europe: past and present”.

Katër eksperte te divizionit (labororit) për analiza kimike te narkotikeve kanë marr pjesë në trajnimet e mbështetura nga UNDP për personelin e Divizionit të Balistikës “Nga fushat e përcaktimit të distancës së qitjes me metoda kimike dhe restaurimi i numrave serik si dhe validimi i këtyre dy metodave” të cilët me sukses e ka përfunduan trajnimin dy javorë.



Foto 18. Ekspertet gjatë trajnimit “Përcaktimit të distancës së qitjes me metoda kimike”

Rishikimi dhe revizionimi i Procedurave të Divizionit (Labororit) për Analiza Kimike të Narkotikëve për vitin 2023, është kryer konform rregulloreve të AKF-së dhe kriterëve të standardit ISO: 17025.

Me sukses dhe profesionalizëm është përfunduar Testi i parë profesional (testi i zotësisë) që organizohet nga kompania UNODC, Internacional Collaborative EXERCISEE (ICE) 2023.

Ekspertët e divizionit (labororit) për analiza kimike të narkotikëve kanë arritur rezultate të larta në testin ndërkombëtare të aftësive profesionale.

Ekspertët e Divizionit për Analiza Kimike të Narkotikëve kanë marrë pjesë aktive në punën e shumë komisioneve brenda AKF-së, duke dhënë kështu kontributin e tyre në punën e këtyre komisioneve, për çështje të ndryshme të rëndësishme – Prokurim, komisione të ndryshme vlerësuese, menaxhim të kontratave etj.

Gjatë këtij viti Divizioni për Analiza Kimike të Narkotikëve ka arritur që ti përmbushë me sukses kërkesat nga kontratat aktive që i posedon për furnizim me material shpenzues dhe kontratat për

shërbime “Për servisim dhe kalibrim të instrumenteve të DAKN” gjë që është mjaftë e rëndësishme për mbarëvajtjen përgjithshme të procesit të punës me instrumente.



Foto 19. Eksertja në trajnim ILEA.

6.3. Divizionit për Analiza të Eksplozivëve dhe Zjarrvënjeve

Divizioni për Analizë Kimike të Eksplozivëve, Zjarrvënjeve dhe Grimcave të Barotit është përgjegjës për analizën dhe identifikimin e Eksploziveve organik dhe inorganik të pashpërthyer apo pas shpërthimit, Zjarrëvenieve dhe analizës dhe identifikimit të mbetjeve të barotit si dhe grimcave të barotit nga kapsolla inicuese (GSR).

Divizioni për Analizë Kimike të Eksploziveve, Zjarrvënjeve dhe Grimcave të Barotit ka realizuar planin vjetor të punës, sipas parashikimeve të planifikuara.

Gjatë vitit 2023 në Divizionin për Analizë Kimike të Eksploziveve, Zjarrvënjeve dhe Grimcave të Barotit janë pranuar 48 raste që janë subjekt i analizës në këtë divizion, prej të cilave shumica Grimca të Barotit por pa i përjashtuar edhe eksplozivet, ndërsa janë kryer (analizuar) dhe rishikuar me sukses dhe profesionalizëm 64 raste, me gjithsej 260 dëshmi.



Foto 20. Eksperti duke punuar në Divizioni për Analizë Kimike të Eksploziveve, Zjarrvënies dhe Grimcave të Barotit..

Rastet	Pranuara	Në Pritje	Në Proces	Ekzaminuara	Dëshmitë
Divizioni për Analizë Kimike të Eksploziveve, Zjarrvënies dhe Grimcave të Barotit	48	22	0	64	260

Tabela 6. Sa i përket dinamikës dhe numrit të rasteve në formë tabelore janë paraqitur statistikisht:

Në divizionin Eksplozive në mungesë të testeve të jashtme profesionale janë organizuar teste të brendshme, janë kryer dhe nuk ka pas ngecje. Një ekspert nga Divizioni për Analizë Kimike të Eksploziveve, Zjarrvënies dhe Grimcave të Barotit, ka marrë pjesë në takimin e 29-të vjetor të grupit punues për Grimcave të Barotit (GSR EWG), të mbajtur me 4 – 6 Tetor 2023 në Bruksel, Belgjikë.

Sfidat

- Mosfunksionimi i sistemit LIMS në Divizionin e DEZGB.
- Numri i vogël i punonjësve në DEZGB
- Angazhimi i vazhdueshëm i ekspertëve në komisione të brendshme dhe të jashtme.
- Numri i madh i kërkesave nga Prokurorët dhe Gjykatësit për kryerjen e rasteve urgjente të DEZGB.
- Angazhimi i stafit në trajtimin e rastit të terrorizmit të 24 Shtatorit në Banjaska të Zveçanit.

7. Departamenti për Teknologji Informative Forenzike

Departamenti për Teknologji Informative Forenzike përbëhet nga dy (2) Divizione:

Divizionii për Ekzaminim të Kompjuterëve dhe

Divizionii për Ekzaminim të Imazhit, Videos dhe Zërit.

7.1. Divizionii për Ekzaminim të Kompjuterëve

Divizionii për ekzaminimin e Kompjuterëve është përgjegjës për kryerjen e ekzaminimeve të kompjuterëve, të telefonisë mobile, SIM kartelave dhe medimeve tjera që përmbajnë të dhëna digjitale dhe administrimin e përgjithshëm të sistemeve: ABIS, IBIS, LIMS, CODIS, RIMS etj.

Gjatë këtij viti Divizionii për ekzaminimin e Kompjuterëve ka arritur që ti përmbush të gjitha objektivat për vitin 2023, përkundër numrit gjithmon në rritje të rasteve dhe kërkesa urgjente për ekzaminim që vinin nga Prokuroritë dhe Gjykatat e Kosovës e që në të shumtën e rasteve ishin urdhëresa për ekzaminim urgjente me masën e paraburgimit.

Ky divizion gjatë vitit 2023 ka kryer gjithsej 401 ekspertiza forenzike me rreth 1.829 dëshmi.

Rastet ndër vite për Divizionii për ekzaminim të kompjuterëve



Grafiku 2. Gjatë vitit 2023 janë pranuar gjithsej 452 raste prej të cilave 401 raste janë përfunduar dhe në vitin 2024 janë bartur vetëm 51 prej tyre.

Dëshmitë e rasteve ndër vite për Divizioni për ekzaminim të kompjuterëve



Grafiku 3. Dëshmitë ndërvite.



Foto 21. Pajisjet Forenzike në fushën e teknologjisë informative gjatë procesit të punës.

Përkundër vështirësive financiare, gjatë vitit 2023 në kuadër të Divizionit për ekzaminimin e Kompjuterëve janë realizuar edhe shumë aktivitete me qëllim të ngritjes profesionale, përcjelljes së trendeve dhe zhvillimeve profesionale ka arritur që përmes përkrahjes së donatorëve ti siguroj disa trajnime dhe konferenca online, dhe me prezencë fizike si më poshtë:

- Basic Operational Analysis Training - (Nga data 08 deri 12 Maj 2023 Online OLAF).
- Drone Forensics – (Nga data 22 deri 26 Maj 2023 Online OLAF).
- MAC Advanced,– (Nga data 25 deri 29 Shtator 2023 Prage, Çeki)

- Digital Skills for Law Enforcement Advancement, – (Nga data 23 deri 27 Tetor 2023 CEPOL Bukuresht, Rumani).

Poashtu gjate vitit 2023 Menaxhmenti i Departamentit te Teknologjise informative forenzike pa participuar ne dy konferenca te rëndësishme forenzike:

- Konferenca për Cyber Intelligence Europe e mbajtur nga data 28.02.2023 deri me 01.03.2023 në Bernë të Zvicërre
- Simpoziumi i dytë të Shkencave Forenzike Turqi-Kosovë e mbajtur nga data 25.04.2023 deri 26.04.2023 në Izmir të Turqisë.

Gjate vitit 2023 Personeli shkencor ka pasur konsultime te vazhdueshme me Prokuror dhe Gjykatës për te bere sqarime dhe prezantime te raporteve te tyre forenzike.

Procesi i vlerësimit për Akreditim

Akreditimi i Departamentit të TI-së Forenzike shënon një hap shumë të rëndësishëm në drejtim të standardizimit dhe profesionalizmit të procedurave dhe metodave të përdorura në këtë fushë. Përmes një procesi të rreptë akreditimi, Departamentit i TI-së Forenzike, krijon baza të forta të cilat garantojnë një nivel të lartë cilësie dhe besueshmërie në përpunimin e dëshmive digjitale.

Pasi ky Departament është i akredituar, autoritetet kanë një siguri më të madhe në metodat dhe teknikat e përdorura për analizën e dëshmive digjitale. Ky fakt kontribuon në një proces gjyqësor më të fortë dhe më të drejtë.

Duke përshtatur praktikat tona me standardet ndërkombëtare, Departamenti i TI-së Forenzike si i akredituar bëhet pjesë e një bashkësie globale të laboratorëve të forenzikës digjitale, duke përmirësuar bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit në nivel ndërkombëtar.

Një aspekt i veçantë i këtij akreditimi është impakti i tij në luftën kundër krimit të organizuar, krimit kibernetik, dhe krimeve tjera të lidhura me teknologjinë. Përmirësimi i kapaciteteve të laboratorit të forenzikës digjitale përmes akreditimit krijon një mjedis ku organet ligj zbatuese mund të luftojnë më efikasitet këto forma të krimit të sofistikuara dhe të përdorin teknologjinë për të siguruar drejtësi dhe siguri.

Në përfundim, akreditimi i parë i laboratorit të forenzikës digjitale në historinë e Kosovës është një shenjë e qartë e angazhimit të vendit drejt një sistemi të drejtësisë më të avancuar. Ky hap përforcon rolin e teknologjisë digjitale në drejtësi dhe krijon një ambient të sigurt dhe të besueshëm për trajtimin e dëshmive digjitale në sistemin e drejtësisë në Kosovë.

Përfundimi me sukses i procesit të akreditimit të Divizionit për Ekzaminim të Kompjuterëve të gjitha procedurave të punës: Procedura për Krijim të Imazhit Forenzik të pajisjeve Digjitale (PRT6.4); Procedura për Ekzaminim të Kompjuterëve(PRT 6.5) dhe Procedura për ekzaminim të Telefonave Mobil (PRT6.6)




Foto 22. Gjatë procesit të vlerësimit ndërkombëtar të procesit të akreditimit.

7.2. Divizioni për Ekzaminim të Imazheve Digjitale, Videos dhe Audio

Divizioni për ekzaminimin e Imazheve Digjitale, Videos dhe Audios është përgjegjës për kryerjen e ekzaminimeve të fotografive me film, digjitale, të pajisjeve elektronike, të videos dhe zërit.


Ky divizion gjatë vitit 2023 ka kryer gjithsej 89 ekspertiza forenzike me rreth 694 dëshmi. Kjo shifër tregon se ky Divizion ka tendencë të rritjes së numrit të rasteve për arsye sepse teknologjia po zhvillohet me hapa shumë të shpejtë dhe nga ne gjithmonë kërkohet që të jemi në trend me kohën dhe zhvillimin e saj për të arritur tek rezultatet e duhura për ekzaminim të provës digjitale.

Rastet ndër vite për Divizioni për Ekzaminim të Imazhit, Videos dhe Zërit.



Grafiku 4. Gjatë vitit 2023 janë pranuar gjithsej 96 raste prej të cilave 89 raste janë përfunduar dhe ne vitin 2024 janë bartur vetëm 7 prej tyre.

Dëshmitë ndër vite për Divizioni për Ekzaminim të Imazhit, Videos dhe Zërit.



Grafiku 5. Rastet dhe dëshmitë ndërvite në menyrë grafike.

Procesi i ekzaminimit të imazhit digjital kërkon profesionalizem dhe përkushtim, në këtë divizion ka rritje të numrit të ekspertizave forenzike, si dhe raste të natyrës urgjente të cilat kryhen sipas kërkesës së prokurorisë.



Foto 23. Eksperti Forenzikë në fushën e teknologjisë informative gjatë procesit të punës.



Foto 24. Programet e Audio zërit gjatë procesit të punës.

Personeli në Divizionin për Ekzaminim të Imazhit, Videos dhe Zërit në kuadër të Departamentit të Forenzikës së TI-se gjatë vitit 2023 ka realizuar disa trajnime dhe konferenca të mbajtura me prezencë fizike dhe pjesa tjetër është mbajtur online të cilat janë si më poshtë:

Trajnimet jashtë Vendit

Stafi i Divizionit për Ekzaminim të Imazhit, Video dhe Zërit gjatë vitit 2023 ka zhvilluar disa trajnime profesionale me ndihmën e donatoreve të ndryshëm kanë kryer trajnime jashtë vendit të cekur si më poshtë:

Kursi Bazik për Ekzaminim të Forenzikës së Kompjuterëve (Basic Computer Forensic Examiner, I mundësuar nga OLAF), nga data 25 Shtator 2023 – 6 Tetor 2023, në Republikën e Qekisë, Pragë.

Pjesëmarrjet në takime (online)

- Oxford Wave Research – TEAPOT 12.12.2023
- CYCLOPES/EJCN joint webinar on ‘Enterprises as a victims of cybercrime’ 07.12.2023
- 'How to create a forensic voice comparison database' 07.11.2023
- C-UAS TIG meeting 15.06.2023
- 2023 ENISA Cybersecurity Certification Conference 22.05.2023
- Quarterly Demo: Options (Part 1) Refresher Training CODIS – 27.04.2023
- European Association for Biometrics iMARS Workshop #1 -30.03.2023
- VOCALISE User Group Meeting – VOCALISE 18.01.2023

Paraqitja në Gjykatë në cilësi të ekspertit

Stafi i Divizionit për Ekzaminim të Imazhit, Video dhe Zërit gjatë vitit 2023 ka Prezantuar në Gjykata dhe Prokurori te vendit sa here qe është ftuar nga ana e tyre. Gjatë vitit 2023 kemi pasur mbi dhjetë ftesa.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme

Ministarstvo Unutrašnjih Poslova/ Ministry of Internal Affairs



AGJENCIA E KOSOVËS PËR FORENZIKË

Kosovska Agencija za Forenziku | Kosovo Agency on Forensic

Zona Industriale

Rruga 12 Qershori nr. 101

10000 Prishtinë – Kosovë

+381 (0) 38 / 200 76302

agjencia.forenzikes@rks-gov.net